

**KONTRATA E PAJTIMIT PER SHERBIMET E KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE AUDIOVIZIVE  
NE RRJETIN FIKS TE OPERATORIT ERGYS ÇAUSHI – PERSON FIZIK**

Lidhet sot me date \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_, ndermjet paleve:

**Ergys Çausi – Person Fizik**, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT \_\_\_\_\_, me seli ne adresen: \_\_\_\_\_;  
(i cili më poshtë do të quhet **Operatori** - Operatori i Rrjetit dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike)

Dhe

**Pajtimtarit** \_\_\_\_\_ (**Emer, Atesi, Mbiemer**), me te dhenat identifikuese sipas formularit te regjistrimit te AKEP, bashkelidhur kesaj kontrate.

**SEKSIONI 1. SHERBIMET**

- AKSES NE INTERNET (ME BANDE TE GJERE – BROADBAND)**
- LIDHJE ME FIBER**       **Antene**       **Koaksial**       **Tjetër (\_\_\_\_\_)**
- SHERBIMI TV**

**SEKSIONI 2: AUTORIZIME**

- Per marrjen ne perdorim, perpunimin, transferimin ose ruajtjen dhe asgjesimin fizik, te te dhenave personale te deklaruar ne kete Kontrate Pajtimi, ne përputhje me ligjin ne fuqi per mbrojtjen e te dhënave personale:

- Pranoj       Nuk Pranoj

**SEKSIONI 4: FATURA E SHERBIMIT DHE ADRESA E DERGIMIT TE FATURES:**

Adresa e dergimit te fatures/ njoftimeve me shkrim: \_\_\_\_\_

Adresa e postes elektronike: \_\_\_\_\_

Numer kontakti (celular) \_\_\_\_\_

Fature elektronike  PO       JO

*Shenim: Pajisja me fature elektronike automatikisht zevendeson pajisjen me fature fizike.*

**Ne cilesine e Pajtimtarit, deklaroj se:**

- Jam njohur me Informacionin Para-Kontraktor te vendosur ne dispozicion nga Operatori, ne faqen e internetit të Operatorit;
- Jam njohur dhe pranoj kushtet dhe termat e Kontates se Pajtimit, si dhe deklaroj se do t'i zbatoj ato perkatesisht, perfshire por pa u kufizuar ne: Sherbimet e kontraktuara, afatin e kontrates dhe perfundimin e saj, cmimin dhe tarifat, menyren dhe afatet e pageses, dhe/ ose garancive financiare;
- Te dhenat e plotesuara ne Kontraten e Pajtimit dhe Formularin e AKEP jane te sakta dhe i perkasin personit/subjektit tim, referuar mjetit te identifikimit te paraqitur personalisht prej meje;
- Deklaroj se qellimi i blerjes se sherbimit eshte per perdorimin e sherbimit sipas kategorise Familjar/Biznes dhe ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate dhe ne asnje rast per rishitje apo perdorim per qellime fitimi apo ne kundershtrim me ligjin. Deklaroj qe te dhenat e mesiperme jane te verteta;

- Numri i kontaktit (celular) dhe adresa elektronike jane te sakta dhe do te perdoren per njoftime zyrtare per kete kontrate si dhe per autentifikime apo sherbime te tjera ne kuader te kesaj kontrate;
- Mora dijeni te plote dhe pranoj te gjitha kushtet e mesiperme.

**Kontrata e Pajtimimit perbehet nga:**

- Lidhja 1:** Termat dhe kushtet e pergjithshme te ofrimit te sherbimit  
Aneksi 1: Lista e tarifave standarte dhe Udhezuesi per Zgjidhjen e Ankesave
- Lidhja 2:** Plani tarifor  
Aneksi 1 Perfitime te tjera (nese jane te aplikueshme)  
Aneksi 2: Formulari i marrjes ne dorezim te pajisjeve  
Formulari rregjistrimit te AKEP

Lidhjet e kontrates se bashku me anekset respektive dhe Formulari i AKEP jane pjese integrale dhe e pandashme e saj.

Termat dhe kushtet e pergjithshme te ofrimit te sherbimit, Informacioni Para-Kontraktor dhe tarifat standarte jane te publikuara ne faqen zyrtare te Operatorit [www.ergyscaushi.al](http://www.ergyscaushi.al).

Kontrata e Pajtimimit hartohet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) origjinale te njevlershem ne gjuhen shqipe, nje per Operatorin dhe nje per Pajtimtarin.

**Per Operatorin**

**Pajtimtari**

## LIDHJA 1

### TERMAT DHE KUSHTET E PERGJITHSHME TE OFRIMIT TE SHERBIMIT

#### **NENI 1 OBJEKTI KONTRATES**

Ofrimi i sherbimit te aksesit ne internet me bande te gjere dhe/ose TV nga Operatori, nepermjet rrjetit te tij te komunikimeve elektronike me specifikimet e dhena ne Lidhjen 1, sipas kerkeses se pajtimtarit.

#### **NENI 2 TARIFAT**

2.1 Tarifate standarde, te ofruara nga Operatori dhe te pranuar nga Pajtimtari, paraqiten ne Aneksin 1 te kesaj Lidhje dhe jane pjese integrale e Kontrates se nenshkruar midis paleve.

2.2 Plani tarifor i perzgjedhur nga Pajtimtari paraqitet ne Lidhjen 2 te Kontrates se Pajtimtimit.

2.3 Tarifate e Sherbimeve jane objekt ndryshimi, te cilat vendosen dhe publikohen sipas kerkesave te ligjit Nr. 9918, date 19.05.2008, "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

#### **NENI 3 KOHEZGJATJA**

3.1 Kjo kontrate lidhet per nje afat minimal te pakten prej \_\_\_ muajsh ose 12 muaj ose me shume. Ne cdo rast, afati minimal i produktit te kontraktuar, parashikohet ne Lidhjen Nr.2, Plani Tarifor“.

3.2 Ne rast perfundimi te kesaj kontrate nga Pajtimtari perpara perfundimit te afatit minimal, ky i fundit detyrohet te paguaje penalitet per perfundim te kontrates para afatit. Penaliteti do te jete proporcional dhe perfshin pagimin e vleres se plote te pajtimtimit mujor per pjesen e mbetur te afatit te kontrates.

3.3 Operatori do te njoftoje Pajtimtarin nepermjet sherbimit postar/ e-mail/ SMS/ apo formave te tjera te komunikimeve elektronike te qendrushme, 30 dite perpara perfundimit te afatit minimal te kontrates.

3.4 Ne rast se Pajtimtari, nuk shprehet me shkrim per perfundimin e kontrates brenda afatit 30 ditore te njoftimit per perfundimin e afatit minimal te kontrates, palet bien dakord se kontrata, kalon ne nje kontrate me afat te pacaktuar. Gjate afatit te pacaktuar, Pajtimtari do te tarifohet sipas planit tarifor baze te perzgjedhur ne Lidhjen 2.

#### **NENI 4 DETYRIMET**

##### **4.1 OPERATORI DETYROHET:**

4.1.1 Te mundesojte per pajtimtarin sherbim konform standarteve te parashikuara ne kete Lidhje dhe anekset e saj. Pavaresisht kesaj, cilesia e sherbimit te ofruar nga Operatori mund te ndikohet nga faktore te tjere, te cilet jane jashte kontrollit te Operatorit, duke perfshire por mos u kufizuar me zonen e mbulimit, distancen, teknologjine e ofrimit te sherbimit, pajisjet fundore, kushtet atmosferike etj., qe mund te ndikojne ne parametrat e sherbimit te ofruar.

4.1.2 Te aktivizojte ofrimin e Sherbimit, brenda 3 diteve pune nga nenshkrimi i Kontrates se Pajtimtimit. Ne kete afat perjashtohen vonesat e krijuara nga Pajtimtari.

4.1.3 Te ofrojte sherbime te komunikimeve elektronike dhe/ose sherbimin TV ne perputhje me parimin e transparences, proporcionalitetit dhe barazise sipas kushteve dhe cmimeve, sipas llojit te teknologjise se perdorur, kategorise se pajtimtareve, volumit te trafikut dhe metodeve se pageses.

4.1.4 Te evidentojte ankesat dhe shqetesimet e Pajtimtarit dhe ta informojte ate per zgjidhjen e mundshme te tyre brenda afateve te percaktuara ne kete Lidhje dhe Aneksin 1.

4.1.5 Te riparoje defektet teknike dhe te rivendose ofrimin e sherbimit perkatesisht sipas afateve te percaktuara ne kete Lidhje dhe Aneksin e saj. Ne cdo rast, keto afate do te llogariten nga momenti i njoftimit ne numrat e informacionit te Operatorit.

4.1.6 Te riaktivizojte sherbimin brenda 24 (njezetekater) oreve, nga momenti qe Pajtimtari ka shlyer te gjitha detyrimet financiare ndaj Operatorit, por ne cdo rast me kusht qe pagesa te jete kryer perpara perfundimit te kontrates.

4.1.7 Te njoftojte nepermjet medias dhe afishimeve, prane njesise ankimore e zyrate te tij, cdo ndryshim te tarifave te Sherbimeve, jo me vonese se 7 dite kalendarike, jo me pak se 3 (tre) dite rrjesht, perpara zbatimit te tyre.

4.1.8 Pas kerkeses nga pajtimtari me shkrim apo nepermjet aplikimeve online, nese keto te fundit ofrohen nga operatori, te kryejte ndryshimin e paketes se sherbimit ose shpejtesise se transmetimit per sherbimin e aksesit ne internet.

4.1.9 Operatori nuk mban pergjegjesi per problemet/ defektet apo demet direkte ose indirekte qe mund te vijne si pasoje e perdorimit te Internetit ne menyre te pavarur nga Pajtimtari si p.sh. hapjes se faqeve te ndryshme te Internetit, shkarkimit te programeve nga Interneti, demtimi nga viruset, aplikimi i formave te pagesave online etj.

4.1.10 Te njoftojte Pajtimtarin per modifikime te Kontrates jo me vonese se 30 dite perpara dates se hyrjes ne fuqi te ketyre modifikimeve.

4.1.11 T'i jape Pajtimtarit nje shpjegim te hollesishem te te gjitha kushteve te perdorimit dhe kontrates para nenshkrimit te kontrates, nepermjet Informacionit Para-Kontraktor, te publikuara ne faqen zyrtare te internetit te Operatorit.

4.1.12 Ky Informacion Para-Kontraktor perfshin por nuk kufizohet ne nje informacion te detajuar per planet tarifore qe mund te zgjedhe Pajtimtari, duke i dhene mundesine e krahasimit midis tyre, perfshire:

i. Informacion te plote dhe te qarte, per paketat tarifore dhe ofertat promocionale apo speciale si zbritjet e tarifave, trafik i pakufizuar apo perdorim i pakufizuar i Internetit, kohen e kryerjes se thirrjeve apo perdorimit te internetit, duke specifikuar midis te tjerave cfare perfshihet ne pakete/oferte dhe cfare nuk perfshihet ne to, afatet kohore te ofertave dhe efektet e tejkalkimit te tyre, perfshire tarifate e aplikuar.

ii. Sistemin tarifor te aplikuar per sherbimet si kufizime te perdorimit, koha e tarifimit, menyra e tarifimit pas kalimit te kohes minimale ose tejkalkimit

te kufizimit, njesia e matjes per tarifimin (p.sh. MByte etj.), ndryshimi i tarifes me kohezgjatjen, etj.

iii. Sherbimet shtese te perfshira ne paketen e zgjedhur.

iv. Informacion per cilesine e sherbimeve te ofruara/zgjedhura perfshire informacion dhe sqarime per shpejtesine e Internetit.

4.1.13 Te mos refuzoje lidhjen ne rrjet te pajisjeve fundore qe jane ne perputhje me Ligjin nr. 9918 date 19.05.2008, i ndryshuar, dhe akteve nen-ligjore te tij.

4.1.14 Operatori mund te ofroje pajisje fundore per pajtimtarin.

4.1.15 Termat dhe kushtet e rena dakort ne lidhje me pajisjet fundore, çmimi i pajisjes fundore dhe rimbursimi i kostove te pajisjeve ne rast perfundimi te kontratës (nëse aplikohen), do te paraqiten ne nje aneks te vecante te kontrates se pajtimit.

4.1.16. Te aplikojë rritjen e tarifës së një apo më shumë sherbimeve të zgjedhura nga pajtimtari në kontratë, vetëm pas ezaurimit të procesit të njoftimit të pajtimtarit nga Operatori në një nga format e mëposhtme:

- Nepermjet njoftimit individual me poste/e-mail/SMS, apo forma të tjera të komunikimeve elektronike të qendrueshme, të pakten 30 (tridhjetë) dite përpara hyrjes në fuqi të tyre, në rastin kur rritja e tarifave aplikohet nga Operatori. Njoftimi individual duhet të përshijë adresën së ku janë publikuar rritjet e tarifave, në rast se njoftimi nuk përmban detaje të mjaftueshme të ndryshimeve.

4.1.17 Te aplikojë automatikisht edhe pa njoftim uljen e tarifës të një apo më shumë sherbimeve të zgjedhura nga pajtimtari në kontratë, brenda paketës së zgjedhur në Aneks dhe përmirësimin e treguesve të cilësive së sherbimeve të kontraktuara nga Pajtimtari.

4.1.18 Te mos vendosë detyrim financiar për rilidhje në rrjet, nëse ndërpreja e sherbimit është kryer për shkak të gabimeve të Operatorit.

4.1.19. Për paketat tarifore, që kanë tarifim të përkallëzuar, për përdorim të sherbimit "download" dhe/ose "upload", deri në një nivel të caktuar limit (kufizim), dhe mbipagesë për përdorim mbi kufizimin (tarifë për Mbyte), Operatori ka detyrimin të kryejë njoftimin e pajtimtarit nepermjet mjeteve elektronike (si p.sh. mesazh në PC, etj) jo më pak se 3 (tre) ditë rresht kur arrihet niveli 80% i kufizimit "download"/"upload" (nëse ka të tillë).

4.1.20 Operatori ka detyrim që në faqen kryesore të website zyrtar të tij të ofrojë një instrument matje të shpejtesisë të aksesit në Internet për pajtimtarin. Matesi i shpejtesisë ofron mundësinë për të matur të pakten:

a.download speed (shpejtesinë e shkarkimit) në Mbps ose Kbps;

b.upload speed (shpejtesinë e ngarkimit) në Mbps ose Kbps

c. latency (vonesën e lidhjes) në milisekonda;

4.1.21 Shpejtesia e sherbimit të aksesit në internet, për arsye teknologjike i ofrohet Pajtimtarit deri në shpejtesinë që i korrespondon shpejtesisë së përzgjedhur nga Pajtimtari në planin tarifor përkatës dhe Operatori do të bëjë përpjekjet maksimale në lidhje me këtë.

4.1.22 Operatori do të marrë dhe zbatojë masa teknike dhe organizative për të siguruar rrjetin, sherbimin, konfidencialitetin e komunikimit dhe të dhenat e trafikut të komunikimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9918, date 19.05.2008, i ndryshuar.

4.1.23 Operatori mund të ndermarre masa të arsyeshme për menaxhimin e trafikut për të evituar rreziqe nga mbingarkesa të rrjetit apo sigurimin e parametrave të cilësive së sherbimit, masa të cilat nuk do të zbatohen për një kohë me të gjatë se sa është e nevojshme.

4.1.24 Te lajmërojë pajtimtarin nepermjet sherbimit postar/e-mail/SMS/apo formave të tjera të komunikimeve elektronike të qendrueshme në faqet e tyre apo në pikat e shitjes:

- Për ndërprerjet dhe cilësive e dobët të sherbimit të ofruar, gjatë kontrolleve periodike, riparimeve apo përmirësimeve të rrjetit, provave të planifikuara si edhe ditën dhe kohezgjatjen e ndërprerjes apo cilësive e dobët të sherbimit jo më vonë se 24 orë përpara përfundimit të tij efektiv.

- Për kufizimet në ofrimin e sherbimeve të imponuara nga autoritetet kompetente në kushte të jashtëzakonshme, fatkeqsive apo avarive të lidhura me mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, pa ja hequr përgjegjësinë për normalizimin e gjendjes brenda një periudhe sa më shkurtër të jetë e mundur.

4.1.25 Operatori mund të ndermarre masa deri në pezullimin e sherbimeve si kundërveprim ndaj incidenteve të sigurisë ose integritetit apo për shkak të kercenimeve dhe cenimeve ndaj rrjetit/sherbimit.

4.1.26 Te sigurojë kushte për pranimin e pagesave nga Pajtimtarit, për gjatë gjithë ditëve të javës, me orar 08<sup>00</sup>–20<sup>00</sup>.

4.1.27 Te trajtojë dhe të zgjidhë brenda 3 (tre) ditëve kalendarike, kërkesën e Pajtimtarit për çdo ndryshim të sherbimeve shtese dhe të kategorisë së pajtimit.

4.1.28 Te njoftojë me shkrim/sms/etj, për zbatimin e sanksioneve sipas parashikimeve të kësaj kontrate në rast mospërmirësime të detyrimeve kontraktore nga Pajtimtari.

4.1.29 Te trajtojë kërkesat/ankesat me shkrim të Pajtimtarit.

4.1.30 Te publikojë treguesit e cilësive për shërbimin internet.

4.1.31 Te zbatojë, për zgjidhjen e mosmarreveshjeve me Pajtimtarin, procedura të thjeshta dhe efektive.

4.1.32 Te riaktivizojë automatikisht sherbimin e pezulluar nga pajtimtari, sipas kërkesës së këtij të fundit, menjëherë pas përfundimit të afatit të pezullimit të sherbimit të përcaktuar në kërkesë.

4.1.33 Te rimbursojë pajtimtarin për mbifaturime për sherbimet e ofruara.

4.1.34 Te mundesoje akses te barabarte dhe mundesi zgjedhjeje per pajtimtaret me aftesi te kufizuara, sipas percaktimeve ligjore dhe akteve nenligjore ne fuqi, ne lidhje me kete.

4.1.35 Te mundesoje per pajtimtarin ne menyre te thjeshte dhe pa pagese ndalimin automatikisht te thirrjeve te ridrejtuar nga nje pale e trete ne drejtim te pajisjes fundore te pajtimtarit.

4.1.36 Te kryeje monitorim te vazhdueshem te sherbimeve dhe te marre masa per riparimin e problemeve teknike ne kohen me te shkurter qe te jete e mundur por jo me shume se 72 ore. Afati i riparimit fillon nga momenti i njoftimit te problemit nga pajtimtari apo nga konstatimi i tij nga Operatori, perjashtuar rastet kur vonesa vjen nga Pajtimtari.

4.1.37 Operatori duhet te ruaje informacionin sipas kushteve te vendosura ne ligj dhe duhet te behet i vlefshem per pajtimtaret me kerkesen e tyre me shkrim, sic percaktohet nga ligji.

4.1.38 Operatori merr persiper realizimin e aktivizimit te sherbimit te kontraktuar dhe riparimin e defekteve apo zgjidhjen e ankeses se pajtimtarit brenda 3 diteve pune nga data e nenshkrimit te kontrates apo nga data e konstatimit te defektit ose paraqitjes se ankeses nga pajtimtari. Per ankesa specifike ne lidhje me faturimin, koha e zgjidhjes mund te jete me e gjate se 3 dite, por ne te gjitha rastet jo me vone se data e daljes se fatures se muajit pasardhes per te cilin pajtimtari ka bere ankesen.

4.1.39 Te vendos ne dispozicion te personave me aftesi te kufizuar versionin ne "large print" ose "braille" te kontrates se pajtimtit. Detajet te kontaktit te sipermarresit per kete qellim publikohen ne faqen zyrtare te internetit te Operatorit.

## **4.2 PAJTIMTARI DETYROHET:**

4.2.1 Te siguroje me shpenzimet e tij instalimin e sherbimeve dhe/ose pajisjen e nevojshme per lidhjen e sherbimit te internetit (Modem/Spliter/Ruter/etj) dhe/ose pajisjen e nevojshme per lidhjen e sherbimit TV. Ne rastet kur pajisjet ofrohen nga Operatori, pajtimtari eshte i detyruar ti ktheje ato, ne gjendje pune, ne përfundim te kontratës, ose te kompensoje ne vlere monetare pajisjet, duke zbritur koston e amortizimit.

4.2.2 Te kryeje pagesen per sherbimin e ofruar, sipas menyres dhe afateve te percaktuara ne Kontrate dhe Lidhjet/ anekset e saj si dhe te marre dhe ruaje kopjen e dokumentave qe vertetojne kryerjen e veprimeve financiare per pagesen e fatures.

4.2 Te likujdoje te gjitha detyrimet financiare ndaj Operatorit, qe kane lindur deri ne momentin e perfundimit te kontrates.

4.2.1 Te perdore sherbimin e ofruar ne perputhje me kategorine e pajtimtit te percaktuar ne Kontrate.

4.2.2 Te mos perdore sherbimin e ofruar per qellime ilegale, per te shqetesuar, fyer apo kercenuar Pajtimtaret e rrjeteve te tjera te komunikimeve

elektronike, apo per te kryer vepra qe bien ne kundershtim me Legjislacionin Shqiptar.

4.2.3 Te mos keqperdore sherbimin dhe te mos vendose ne rrezik sigurine dhe integritetin e rrjetit te Operatorit.

4.2.4 Te mos perdore sherbimin per qellime rishitje.

4.2.5 Te mos transferoje sherbimin ne palet e treta.

4.2.6 Te mos ofroje ne cdo forme, per nje arsye apo nje tjetër, as te krijojë kushte per kopjim, regjistrim, ritransferim ose perdorim te permbytjes dhe sherbimeve per qellime te tjera, dhe pa kapercim ose perpjekje te kaperceje mekanizmat per mbrojtjen e programeve kunder veprimeve te tilla dhe/ose perdorime te paautorizuara.

4.2.7 Te lidhe ne rrjet vetem pajisje te certifikuara dhe te sigurohet qe teknologjia e tyre eshte e pershtatshme me ate qe kerkohet ne sherbimin e aksesit ne internet te Operatorit.

4.2.8 Te mos zbatoje, apo lejoje persona te paautorizuar, te bejne ndryshime ne pajisjet e komunikimeve elektronike dhe/ose rrjetit dhe te mos lejoje keta te fundit te lidhen te pajisjet e tyre pa njoftimin me shkrim me pare te operatorit.

4.2.9 Te mos demtoje instalimet apo pajisjet telefonike, por pa u kufizuar vetem ne to, te Operatorit, te cilat ndodhen ne territorin dhe objektet prone private ose publike.

4.2.10 Te lejoje ne rast nevojë, per realizimin e ofrimit te sherbimit te pajtimtarit, hyrjen ne pronat private, te punonjesve te autorizuar te Operatorit, per përmbyshjen e kontrates.

4.2.11 Te mos kaloje apo transferoje te te tretet te drejtat dhe detyrimet ndaj Operatorit sipas kontrates se pajtimtit, pa miratimin me shkrim te ketij te fundit.

4.2.12 Te njoftoje me shkrim Operatorin, per cdo ndryshim te te dhenave te tij identifikuese, apo te dhenave te komunikimit mes paleve. Deri ne njoftimin e ndryshimeve te tilla, faturat dhe cdo komunikim/njoftim tjetër do te vijoje kryhet ne pikat e kontaktit te percaktuara ne kontrate.

4.2.13 Te mos lejoje akses per te miturit ne programe pornografike ose programe te tjera dhe ose ne adresa interneti te papershtatshme.

4.2.14 Te mbroje dhe te menaxhoje me kujdesin e tij pjeset e perbashketa te rrjetit te komunikimeve elektronike te operatorit te ndertuara ne pronen e pajtimtarit dhe/ose pronen ne perdorim. Pajtimtari nuk do t'u lejoje akses paleve te treta ne keto pjese te rrjetit, pervec se me miratimin e operatorit.

4.2.15 Te ndihmoje operatorin ne ndertimin e pjeseve te perbashketa dhe te aferta te rrjetit, duke perfshire kanalet e lidhjeve te rrjetit te godines per rrjetin e komunikimeve elektronike publike te Operatorit dhe instalimin e rrjetit te komunikimeve te godines.

4.2.16 Te paguaje per demet e shkaktuara me dashje (paramendim) per Operatorin qe jane direkte (te drejtperdrejta), te menjehershme me veprimet e tyre dhe prishin detyrimet sipas kesaj kontrate. Pajtimtari mund te deshtoje ne plotesimin e ndonje detyrimi te

parashikuar ne kete kontrate, ne rastin e nje force madhore. Ne keto raste, ai do te njoftohet ne kohe nga Operatori per natyren, forcen madhore dhe pasojat e mundshme, per plotesimin e detyrimeve te tyre.

4.2.17 Te ktheje aparatit apo pajisjen e komunikimeve elektronike te marre ne perdorim ne kushtet qe i jane dhene, perveqese per perdorim funksional normal, brenda 5 (pese) diteve kalendarike, ne rastet e perfundimit te kontrates nga Operatori. Ne rastin e perfundimit te kontrates nga ana e Pajtimtarit, Operatorit i lind e drejta te kerkoje kthimin e aparatit apo pajisjeve te komunikimeve elektronike ne perdorim ne momentin e paraqitjes se kerkeses per perfundim Kontrate.

4.2.18 Te paguaje te gjitha detyrimet e papaguara, duke perfshire faturat e papaguara, faturen e emetuar nga Operatori deri ne ditën e ndërprerjes se kontrates.

## **NENI 5. TE DREJTAT**

### **5.1 OPERATORI KA TE DREJTE:**

5.1.1 T'i nderprese ofrimin e Sherbimit dhe ose sherbimeve, pajtimtarit i cili nuk ka zbatuar detyrimet qe rrjedhin nga percaktimet e Nenit 4.2.

5.1.2 Te nderprese sherbimin objekt kontrate ne menyre te njeanshme, duke njoftuar te pakten 24 ore me perpara, per qellime mirembajtje dhe permiresimin e sherbimit. Kohezgjatja e nderprerjes te jete jo me shume se 48 ore.

5.1.3 Te ndryshoje tarifat e ofrimit te Sherbimit gjate vlefshmerise se kontrates, sipas kushteve te percaktuara ne piken 4.1.

5.1.4 Te beje ndryshime e permiresime ne rrjetin e tij te telekomunikacioneve sipas nevojave te zgjerimit te rrjetit dhe te teknologjise.

5.1.7 Te mos pezulloje sherbimet, pavaresisht kerkeses se pajtimtarit, kur sherbimet ofrohen se bashku ose jane ngushtesisht te lidhur me njeri-tjetrin. Operatori ne cdo rast, mund te vendose ne diskrecion te tij ndryshe.

5.1.8 Te ndryshoje ne cdo kohe kanalet televizive, numrin dhe renditjen e kanaleve televizive, perfshire, por pa u kufizuar, ne pakesim apo shtim te numrit te tyre ne perputhje me parashikimet e marreveshjeve qe Operatori ka me palet e treta.

5.1.9 Ne cilesine e perseritesit te mediave audiovizive te te tretteve, Operatori nuk ka kontroll mbi numrin e kanaleve televizive dhe nuk ka asnje pergjegjesi ne lidhje me renditjen, pakesimin, shtimin, cilesine dhe permbajtjen e kanaleve qe ritransmeton.

5.1.10 Te aplikojte dhe zbatojte kerkesat e pajtimtarit te paraqituar nga ky i fundit me shkrim apo nepermjet aplikimeve online, sipas kushteve te kesaj kontrate dhe anekseve te saj.

5.1.11 Te refuzojte te ekzekutoje nje kontrate sherbimesh, per lidhje ne rrjet ose rikthimin e aksesit te rrjetit te pezulluar perkohesisht dhe te ndaloje

ofrimin e disa apo gjithe sherbimeve ne raste kur pajtimtari:

- Deshton per te siguruar te dhena dhe dokumente sipas kontrates ose kur kushtet e nevojshme per ofrimin e sherbimeve nuk jane plotesuar, perfshire aksesin dhe perdorimin e energjise elektrike ne pronen apo godinen dhe kushte te tjera te ngjashme.

- Ka kaluar afatet ose ka vonuar detyrimet per pagesen e sherbimit/ve te ofruar nga operatori.

- Ka perdorur apo ka lejuar perdorimin e pajisjeve te komunikimeve elektronike ose sherbimeve elektronike per qellime dhe ne kundershtrim me parashikimet e kontrates dhe legjislacionin ne fuqi.

- Ka hyre apo eshte perpjekur te siguroje akses te sherbimit e Operatorit ne nje menyre te parregullt, te papajteshme me kontraten e pajtimtarit dhe rregulloret perkatese per ofrimin e sherbimeve objekt kontrate apo te ndaluara me ligj.

5.1.12 Te mos ofroje sherbimin sipas kontrates se pajtimtarit, kur pajtimtari ka ndermarre vete apo ka lejuar pale te treta te paautorizuara te marrin persiper instalimin, modifikimin apo riparimin e pajisjeve dhe/ose te rrjetit.

5.1.13 Operatori nuk do te jete i detyruar ndaj pajtimtarit per:

- Demin qe nuk shkaktohet nga veprimet direkte apo indirekte nga Operatori;

- Mosplotesim te detyrimeve te tij per shkak te nje force madhore gjate kohezgjatjes se saj;

- Permbajtjen e informacionit te transmetuar nepermjet rrjetit;

- Nderprerjen dhe/ose cilesine e ulet te sherbimeve te komunikimeve elektronike kur kjo eshte ne kufij te parametrave teknike dhe cilesine e rrjeteve te tjera te komunikimeve elektronike, si dhe demet dhe /ose prishjet ne keto rrjete;

- Nderprerjen dhe/ose cilesine e ulet te sherbimeve te komunikimeve elektronike kur kjo ndodh per mungesen, pezullimin, ose prishjen e parametrave teknike te cilesise te pajisjeve te energjise te godinave dhe/ose banesave;

- Mungesen e ofrimit te sherbimeve ose cilesine e dobet te tyre gjate testimeve qe kryhen nga operatori me qellimin per te inspektuar pajisjet, lidhjet, rrjetet, etj., si edhe testet me qellim permiresimin apo efektshmerine e sherbimit te ofruar, vetem subjekt per pajtimtarin duke e mbajtur kete te fundit te informuar paraprakisht.

5.1.14 Operatori ka te drejte te aplikojte politikat e perdorimit te drejte te sherbimeve dhe/ose produkteve te ofruara per pajtimtarin te cilat ne cdo rast do te jene ne perputhje me rregulloret dhe dispozitat ligjore dhe nenligjore perkatese ne fuqi.

### **5.2 PAJTIMTARI KA TE DREJTE:**

5.2.1 Te perdore sherbimin objekt kontrate ne perputhje me termat e kesaj kontrate.

5.2.2 Te kerkoje apo te kryeje me shkrim apo nepermjet aplikimeve online/aplikacioneve te aplikuara nga Operatori ndryshime te tipit te paketes, shpejtesise se transmetimit apo te adreses (vendodhjes), apo blerje ofertash promocionale/paketash shtese per te cilat palet bien dakort.

5.2.3 Te kerkoje me shkrim perfundimin e kontrates ne menyre te njehanshme, por duke perbushur kushtet e kontratës.

5.2.4 Te percaktoje sherbimet fillestare dhe sherbimet shtese qe do te perdore sipas Aneksit te kontrates.

5.2.5 Te kerkoje rilidhjen e Kontrates se Pajtimit, pas shlyerjes se te gjitha detyrimeve te prapambetura.

5.2.6 Te pezulloje perdorimin e sherbimeve pas paraqitjes se kerkeses me shkrim ndaj Operatorit, jo me vone se 10 dite kalendarike perpara dates se pezullimit.

5.2.7 Ne cdo rast, pezullimi i sherbimit nuk mund te kerkohet me shume se dy here brenda 12 muajve dhe ne cdo rast koha totale e pezullimit nuk mund te jete me e gjate se 3 muaj.

5.2.8 Periudha e pezullimit ne cdo rast do t'i shtohet afatit te kontrates apo produktit te perfituar nga pajtimtari. Sherbimet e pezulluara do te riaktivizohen automatikisht me mbarimin e periudhes se specifikuar ne kerkesen e pajtimtarit. Tarifa e pezullimit do te percaktohet sipas listes se çmimeve ne fuqi. sherbimit/sherbimeve.

5.2.9 Te mos paguaje ndonje tarife gjate periudhes se pezullimit te sherbimit, pervec asaj te pezullimit te sherbimit, e cila eshte e pagueshme ne momentin e paraqitjes se kerkeses per pezullim sherbimi.

5.2.10 Ne rastin e sherbimeve qe ofrohen se bashku apo per shkak te natyres se tyre jane ngushtesisht te lidhura me njera tjetren, pezullimi i sherbimit nuk do te ofrohet vetem per sherbimet me vehte. Operatori ne çdo rast mund te vendose ne diskrecionin e tij ndryshe.

5.2.11 Te revokojë ne cdo kohe pelqimet paraprake te dhena prej tij me paraqitjen e kerkeses ne nje nga format e parashikuara ne kete kontrate.

5.2.12 Te marre pa pagese fature per sherbimet, si edhe te kete akses ne informacionin online te faturave mujore. Fatura e detajuar permban te pakten informacion lidhur me: numrat dhe llojet e sherbimeve te periudhes raportuese; shumen totale sipas llojeve te sherbimeve; shumen totale te fatures; taksat e aplikuara; shumen e zbritjeve per pajtimtarin; shumen totale perkatese; periudhen e pageses; menytrat e mundshme te pageses, kredencialet e operatorit dhe personat e kontaktit dhe i mundesohet pajtimtarit vetem me kerkese te ketij te fundit pa pagese per periudhen paraardhese.

5.2.13 Ne rastet kur operator, nuk ekzekuton brenda afateve te percatuara ne kete Lidhje, kerkesen e pajtimtarit per nderprerjen e njehanshme te kontrates, kontrata nuk do te konsiderohet e nderprere dhe

pajtimtari do te gezoje te gjitha te drejtat dhe detyrimet e parashikuara ne kete Lidhje.

## **NENI 6 FATURIMI**

6.1 Faturimi per Pajtimtarin do te jete me baze mujore dhe do te kryhet sipas percaktimeve kesaj kontrate dhe anekseve te saj.

6.2 Fatura i dorezohet Pajtimtarit ne menyren dhe formen e kerkuar nga pajtimtari, jo me vone se pesembedhjete dite kalendarike perpara afatit te pageses se saj. Per kategorine jo individ, fatura do ti komunikohet Pajtimtarit ne perputhje me parashikimet ligjore ne fuqi dhe percaktimeve specifike mbi fiskalizimin.

6.3 Pajtimtari do t'i paguaje operatorit nje çmim, per sherbimet e ofruara, respektivisht:

6.3.1 Çmimin fillestar per akses ne rrjet dhe/ose aktivizimin e sherbimit (kur aplikohen) per te cilin eshte lidhur Kontrata e Pajtimit. Çmimi do te paguhet brenda afatit sipas kontrates dhe nuk eshte subjekt i kompesimit me perfundimin e kontrates.

6.3.2 Vleren e gjithe sherbimeve te perdorura gjate periudhes se faturuar. Periudha e faturimit zgjat nga dita e pare deri te dita e fundit e muajit kalendarik.

6.3.3 Tarifen e pajtimit mujor, e cila i takon plotesimit te aksesit per sherbimet e specifikuara per te cilat nje kontrate eshte lidhur.

6.3.4 Çmimin per pajisjen fundore kur blihet nga operator i ose qerane per perdorimin e pajisjes fundore (kur aplikohen).

6.3.5 Tarifen per asistencë teknike ne perdorimin e sherbimeve, perfshire instalimin, mirembajtjen dhe riparimin e pajisjeve te komunikimeve elektronike te ofruara (kur aplikohen).

6.3.6 Pagesa per te tjera sherbime te specifikuara ne listen e çmimeve te operatorit (kur aplikohen).

6.4 Faturimi per mbipagesen ne rastin e parapagimit do te behet ne faturen e muajit pasardhes.

6.5 Operatori faturon sherbimet e ofruara me parapagim ose paspagim, sipas specifikimeve ne Aneksin perkates te produktit te ofruar.

6.6 Ne faturen e derguar Pajtimtarit, pervec vlerave te detyrimeve, Operatori perfshin:

- Afatin e pageses se fatures;
- Menyren dhe vendin e pageses se fatures;
- Pagesat shtese;
- Sanksionet ne rast moshlyerje te detyrimeve (kamat-vonesat, nderpreje, kufizim te sherbimeve etj.);

- Numer kontakti te Operatorit per Kujdes ndaj Klientit per informacion per faturen (thirrjet drejt ketij numri jane pa pagese ose me kosto sipas percaktimeve ne aneksin e tarifave perkatesisht).

## **NENI 7. KRYERJA E PAGESAVE**

**Detyrimet financiare te Pajtimtarit ndaj Operatorit kryhen si me poshte:**

7.1 Per vleren e instalimit, aktivizimit te sherbimit, te pajisjes fundore apo konfigurimit te saj, me LEK ne dore, vetem njehere, prane arkës se Operatorit ose me Urdher-Xhirimi ne emer dhe ne favor te Operatorit, sipas percaktimeve ne faturen e leshuar, ne momentin e firmosjes se kesaj Kontrate, referuar tarifave te percaktuara ne Lidhjen 2.

7.2 Pagesat mujore per sherbimet e marra sipas kontratës.

7.3 Detyrimet sipas pikes 7.2 duhet te shlyhen brenda afatit te percaktuar ne fature dhe ne cdo rast jo me vone se dita e fundit e muajit.

7.4 Mosmarrja e fatures nuk e çliron pajtimtarin nga detyrimi per te paguar brenda kohes se percaktuar.

7.5 Date pagese do te konsiderohet:

**a.** Data e shenuar ne mandat arketimi, ne rastin kur pagesa kryhet me LEKE ne dore, prane njesise arketimore te Operatorit.

**b.** Data e prekjes se llogarise bankare likujduese te Operatorit, ne rastin kur pagesa kryhet me Urdher-Xhirimi bankar apo nepermjet sistemit elektronik te pagesave.

## **NENI 8 SANKSIONET**

8.1 Ne rast vonesash ne lidhjen ne rrjet ne afat ose ne aktivizimin e sherbimit, Operatori do te paguaje nje penalitet e masen 0.1% te tarifës fillestare per lidhjen ne rrjet dhe aktivizimin e sherbimit per cdo dite vonese, por jo me shume se 20% te kesaj tarife. Perjashtim nga ky penalitet bejne rastet kur vonesat jane shkaktuar nga veprime apo mosveprime te Pajtimtarit ose paleve te treta, jashte kontrollit te Operatorit.

8.2 Ne rast se sherbimi i kontraktuar nuk ploteson nivelin e cilesise se parashikuar ne kontrate dhe/ose Operatori vonon riparimin e difekteve ne rrjetin e tij te telekomunikacioneve, tej afateve te percaktuara ne kete Kontrate, atehere ai detyrohet t'i zbrese nga fatura e muajit ne vijim ne tarifen e pajtimit proporcionalisht me ditet ne mungese cilesie/vonese riparimi difekti.

8.3 Ne rast se Pajtimtari nuk kryen pagesen e fatures sipas afatit te saj, Operatori ka te drejte te ndermarre sanksione dhe masa kufizuese te ofrimit te sherbimit per Pajtimtarin deri ne perfundimin e kontrates:

**a.** Operatori aplikon per cdo dite vonese nje penalitet ne masen 0.5% te fatures mujore te papaguar dhe brenda 7 diteve pas kalimit te afatit te pageses te percaktuar ne fature, do te njoftoje Pajtimtarin me shkrim ose me SMS/telefonate per permbushjen e detyrimit te pageses dhe/ apo detyrimeve te tjera kontraktore, brenda dates 15 te muajit aktual dhe per kufizimin e ofrimit te sherbimit te telefonise fikse, duke i dhene mundesine pajtimtarit te thirret nga te tjeret (i njeanshem, vetem hyres) dhe te perdore Sherbimet e Emergjences;

**b.** Operatori, pas 15 ditesh nga kalimi i afatit te pageses te percaktuar ne fature, do te ekzekutoje kufizimin e sherbimit te telefonise fikse duke nderprere ofrimin e sherbimit te thirrjeve dalese per telefonine fikse dhe ne te njejten kohe do te vijohet me njoftimet me sms/ telefonate per masat qe mund te ndermerren ne vijim.

**c.** Ne rast mos shlyerjes se detyrimeve me plotesimin/kalimin e 30 diteve te afatit te pageses se percaktuar ne fature, sherbimet e kontraktuara do te nderpritet teresisht. Ne cdo rast thirrjet drejt numrave te emergjences do te lejohen.

**d.** Operatori, gjate muajit te dyte pas afatit te pageses se fatures, gjeneron fature per sherbimet e ofruara gjate muajit te meparshem dhe vijon me njoftimet respektive mbi shlyerjen e detyrimeve edhe per faturen e muajit paraardhes dhe te gjitha detyrimeve kontraktore.

**e.** Ne muajin e trete pas afatit te rregullt te pageses se fatures, operatori i dergon njoftim me shkrim pajtimtarit per permbushjen e detyrimeve brenda 15 diteve nga data e ketij njoftimi dhe nderprerjen e kontrates ne menyre te njeanshme brenda 3 diteve nga kalimi i afatit 15 ditor te percaktuar ne kete paragraf. Ne rast te moshlyerjes se detyrimeve edhe sipas ketij njoftimi, Operatori do te ekzekutoje te drejten e nderprerjes se kontrates me pajtimtarin.

8.4 Operatori nuk eshte i detyruar te njoftoje paraparakisht Pajtimtarin per masat e marra ne rast se shkelja e evidentuar e kontrates:

- perben nje kercenim serioz te rendit e sigurise publike, shendetit e mjedisit;
- shkakton nje demtim serioz fizik, material ose funksional te rrjetit.

8.5 Nese eshte teknikisht e mundshme, Operatori eshte i detyruar te kufizojë aksesin vetem per ato sherbime qe Pajtimtari ka shkelur kushtet e kontrates, pervec rasteve kur Pajtimtari abuzon, ose ne menyre te perseritur kryen me vonese ose nuk paguan faturat.

8.6 Ne cdo rast, kur Pajtimtari vonon pagesen e vleres se fatures, tej afateve te percaktuara ne fature dhe brenda ketij afati nuk ka bere ankese me shkrim per faturen, Pajtimtari detyrohet t'i paguaje Operatorit kamate ne masen 0.5% te fatures mujore te papaguar, per cdo dite vonese ne pagim nga afati i pageses se percaktuar ne fature.

8.7 Ne rast se Pajtimtari ka bere ankese me shkrim per faturen, para afatit te pageses, atehere:

**a.** Operatori ka detyrimin te trajtojë ankesen dhe ktheje pergjigje sipas percaktimeve te kesaj kontrate.

**b.** Operatori mund te mos aplikojë masat kufizuese te referuara me siper.

8.8 Shuma te mbitarifuar per sherbimet e ofruara dhe shumat e ankimuar sipas parashikimeve te kesaj kontrate Pajtimi do te zbriten nga çmimi i pajtimit mujor per muajin/t tjetër/re dhe me perfundimin e Kontrates se Pajtimit do t'i paguhen



pajtimtarit nepremjet llogarise bankare te njoftuar zyrtarisht, nese kushtet per perfundimin e Kontrates se Pajtimt jane plotesuar.

## **NENI 9 PERFUNDIMI I NJEANSHEM I KONTRATES**

9.1 Operatori ka te drejte te nderprese ofrimin e sherbimit dhe te perfundoje ne menyre te njeanshme kontraten pa njoftim paraprak ndaj pajtimtarit ne rastet si me poshte vijon:

- konstaton kundervajtje flagrante, sistematike apo te vazhdueshme te detyrimeve kontraktuale dhe ose te Termave te Pergjithshme te sherbimit. Ne kuptim te ketij parashikimi me shkelje flagrante dhe shkelje sistematike te detyrimit kontraktual do te kuptohen:

- “Shkelje flagrante e detyrimit kontraktual” eshte nje shkelje qe shkakton ose mund te shkaktoje dem tek pajtimtare/perdorues te tjere ose tek operatori,

- “Shkelje sistematike e nje detyrimi kontraktual” eshte nje shkelje qe ka ndodhur dy a me shume here brenda afatit te kontrates.

- pajtimtari me dashje demton/prish ose lejon shkaterrimin/demtimin/thyerjen/e modemit dhe ose pajisjeve te tjera te komunikimeve elektronike te ofruara nga operatori, nese nuk paguan kompensim per cdo dhe te gjitha demet aktuale te shkaktuara ndaj operatorit, perfshire dhe kostot e pajisjes fundore

- sipas parashikimeve te pikes 8.3.e,

- ne rast te forces madhore.

9.2 Pajtimtari ka te drejte ta quaj kete Kontrate te perfunduar ne ditën e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore ne rast se kerkesa per perfundim eshte paraqitur jo me vone se data 25 e muajit.

9.2.1 Ne rast se kerkesa per perfundim paraqitet pas dates 25, kontrata do te konsiderohet e perfunduar ne ditën e fundit te muajit pasardhes.

9.3 Pajtimtari ka te drejte te zgjidhe Kontraten ne menyre te njeanshme dhe pa kosto shtese, duke e njoftuar me shkrim Operatorin brenda nje afati 30 ditor nga data e njoftimit, ne rastet e modifikimit/zevendesimit te kontrates nga Operatori.

9.4 Zgjidhja e kontrates nuk do te heqe detyrimet qe pajtimtari ka ne baze te kontrates se vjeter.

9.5 Pajtimtari ka te drejte te nderprese kontraten ne menyre te njeanshme me nje njoftim me shkrim tek Operatori dhe plotesimin e formularit perkates dhe kontrata do te konsiderohet e perfunduar sipas parashikimeve ne paragrafin 9.2.

9.5.1 Ne cdo rast, Pajtimtari eshte pergjegjes ne lidhje me kryerjen e te gjitha pagesave dhe detyrimeve qe i perkasin kontrates dhe kthimin e aparateve dhe pajisjeve te komunikimeve elektronike ne rast se jane dhene ne perdorim nga Operatori.

9.6 Ne cdo rast, Operatori gezon te drejten te perfundoje kete kontrate ne cdo kohe, me nje njoftim

paraprak 30 ditor drejtuar Pajtimtarit. Perfundimi dhe nderprerja e nje/ disa prej sherbimeve ne menyre te njeanshme nga palet nuk nenkupton edhe perfundimin ne te njejtin afat te kontrates, me perjashtim te rastit kur me kontraten merret vetem nje sherbim.

## **NENI 10 RUAJTJA E FSHEHTESISE SE KOMUNIKIMEVE TELEFONIKE DHE PERDORIMI I TE DHENAVE PERSONALE**

10.1 Operatori detyrohet te siguroje zbatimin e Rregullat ne fuqi lidhur me menyren e mbledhjes, perpunimit apo transferimit te te dhenave personale te pajtimtarit sipas Ligjit nr. 9887/2008, i ndryshuar dhe akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tij. .

10.2 Operatori nuk do te kontrolloje ose te perhape te dhenat personale ose permbajtjen e bisedave te kryera nepermjet rrjetit te Operatori, pervec rastit kur kjo nevojitet si pjese e veprimtarise se mirembajtjes se rrjetit ose parashikohet nga legjislacioni ne fuqi.

10.3 Operatori nuk do te perhape, transmetoje ose te perpujojte te dhenat personale te Pajtimtarit, perfshire (por pa u kufizuar ne) te dhenat per shumat e shpenzuara ose per qellime te tjera nga ato per te cilat jane kerkuar te dhenat, pervec rastit kur nje gje e tille eshte e nevojshme dhe ka lidhje te drejteperdrejte me dhenien e sherbimeve dhe/ose permbushjen e kesaj Kontrate, si dhe rastit kur nje gje e tille parashikohet nga legjislacioni ne fuqi. Pajtimtari mund te informohet ne cdo kohe.

10.4 Operatori do te mbledhe, perpujojte e perhape te dhenat personale te Pajtimtarit per permbushjen e kesaj Kontrate. Te dhenat personale si: emer, mbiemer, nr. personal identifikimi, datelindje, gjinia, fotokopje e mjetit te identifikimit dhe adresa e banimit, jane te dhena te detyrueshme per te bere te mundur regjistrimin dhe lidhjen tuaj me rrjetin. Te dhenat e tjera te kontaktit jane te dhena vullnetare per te perfituar nga sherbimet e kujdesit ndaj klientit. Duke nenshkruar kete kontrate, pajtimtari pranon qe Operatori te perpujojte dhe perhape te dhenat e tij per qellime te kesaj kontrate, ku perfshihen (por nuk kufizohen vetem me to) perpunimi i kerkesave per pajtim ne rrjet, dhenia e sherbimeve dhe produkteve dhe sherbimeve Pajtimtarit, mbajtja e llogarive te transakcioneve, pergatitja e faturave dhe dhenia e sherbimit te kujdesit per klientin (perfshire dergimi i faturave nepermjet sherbimit postar), kontrolli dhe raportimi i kreditit, krijimi i databazes se debitoreve me detyrime te papaguara dhe mbledhja e detyrimeve kontraktore te papaguara nepermjet te tretteve per llogari te Operatori, krijimi dhe matja e bazave te te dhenave dhe platformave te sherbimit, kryerja e analizes e studimeve per informacion biznesi dhe qellime marketingu, profilizim i pajtimtarit, zhvillim i produkteve dhe sherbimeve, ristrukturimi apo riorganizimi i biznesit te Operatori, siguria e rrjetit Operatori dhe e informacionit, mbrojtja e asetave dhe te drejtave te Operatori,

perfshire te drejtat e pronesise intelektuale dhe marken tregtare, punonjesit dhe klientet nga aktiviteti kriminal apo aktivitet tjetër që mund të shkaktoje dëm, për të mbushur detyrimet ligjore dhe rregullatore në lidhje me procedurat ligjore, perfshire dhe mbrojtjen në procese ligjore kundër Operatori si dhe përhapjen e të dhenave të treta me qëllim mbledhjen e detyrimit të pashlyer në rast se Kontrata me pajtimtarin zgjidhet për këto arsye.

10.5 Operatori ose agjentet e tij mundën që, here pas here, të kontaktojnë pajtimtarin nepermjet postes/ telefonit/ e-mail, apo SMS në lidhje me shërbimin e ofruar dhe të pranuar nga pajtimtari (p.sh. për jo kufizuar në: furnizimi i shërbimit të asistencës ose sekretarise telefonike, gjendjen e marrjes së mesazheve ose të pagesave etj.).

10.6 Me pëlqimin paraprak të pajtimtarit, Operatori mund të kontaktojë këte të fundit nepermjet postes/ telefonit/e-mail apo SMS në lidhje me detajet e shërbimeve dhe produktet e reja që Operatori ofron. Në rast se pajtimtari vendos të mos marrë me komunikime të kesaj natyre, mund ta kërkojë këte në çdo moment dhe pa pagesë, me kërkesë në dyqanë ose nepermjet aplikacioneve që Operatori ka krijuar për Pajtimtarët e tij.

10.7 Operatori merr përsiper të respektojë fshëhtesinë dhe privatesinë e Pajtimtarit dhe trajtojë të dhenat personale të Pajtimtarit në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9887, 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhenave Personale”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9918, date 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, aktet nenligjore të dala në zbatim të tyre si dhe për qëllimet e lejuara të biznesit.

10.8 Operatori do të ruajë të dhenat personale të pajtimtarit në përputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara në legjislacionin në fuqi dhe do t'i bejë të vlefshme për pajtimtarin me kërkesën e tij me shkrim, përsa kohe që ende disponohen nga Operatori.

10.9 Të dhenat mbi numrin personal të identifikimit të pajtimtarit mund të perdoren për rigjenerimin e të dhenave nga sipërmarrësi në gjykatë.

10.10 Operatori garanton se nuk kryen përgjime të komunikimeve elektronike. Përgjimi i

komunikimeve elektronike kryhet vetëm nga organet kompetente shtetërore të percaktuara në Ligjin Nr. 9157 date 04.12.2013 “Për përgjimin e telekomunikimeve” (i ndryshuar).

10.11 Në përputhje me parashikimet ligjore, në lidhje me të dhenat personale që përpunohen nga Operatori, ju në çdo kohë keni të drejtat si vijojnë: e drejta për akses, e drejta për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen, e drejta për të mos qenë pjesë e vendimarrjeve automatike, e drejta për të kundërshtuar dhe e drejta për tu ankuar.

10.12 Operatori brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës do ju dërgoj informacionin e kërkuar ose arsyen e mosdhenies ose mosëkzekutimit të kërkesës tuaj. Në çdo rast për ekzekutimin e kërkesave Operatori mund të kërkojë informacion shtesë për identifikimin e saktë tuaj për të shmangur që informacioni juaj të përhapet tek persona të paautorizuar.

## **NENI 11 KUSHTE TE PERGJITHSHME**

11.1 Kjo Kontratë hartohet dhe interpretohet nga Palet në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore të Republikës së Shqipërisë.

11.2 Mosmarrveshjet që lindin ndërmjet paleve zgjidhen sipas percaktimeve në Udhezuesin e Mosmarrveshjeve me pajtimtarin të dhëna si Aneks i kesaj Kontrate. Në rast se palet nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrveshjen me mirekuptim, secila mund t'i drejtohet për shqyrtim AKEP, ose Gjykatës kompetente.

11.3 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palet.

11.4 Në rast përfundimi të Kontrates për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve nga ana e Pajtimtarit, si personalisht, apo si person juridik do të humbasë të drejtën të lidhë një kontratë tjetër me Operatorin pa shlyer me parë detyrimet e tij të prapambetura ndaj Operatorit. Operatori do të ruajë të drejtën e tij për të kërkuar sipas ligjit pagimin e detyrimeve të pashlyera.

11.5 Ndryshimet e Termave të Përgjithshme të Kontrates mund të aplikohen vetëm pas njoftimit përkatës të tyre tek AKEP.

## ANEKSI 1

### Lista e tarifave standard dhe Udhezuesi per Zgjidhjen e Ankesave

#### TARIFAT STANDARTE

Tarifa e regjistrimit: \_\_\_\_\_ Lek

Tarifa mujore e shërbimit Internet: \_\_\_\_\_ Lek

Tarifa mujore e shërbimit TV: \_\_\_\_\_ Lek

Tarifa te tjera: \_\_\_\_\_ Lek

Emertimi i pajisjes se dhene ne përdorim nga Operatori: \_\_\_\_\_

Numri MAC i pajisjes: \_\_\_\_\_

#### UDHEZUES PER ZGJIDHJEN E ANKESAVE

- 1- Ankesat mund te paraqiten :
  - a- Nepermjet numrit \_\_\_\_\_ per “Difekte dhe asistence teknike”, ose aplikacione komunikimesh qe operojnë me kete numer.
  - b- Nepermjet sporteleve Operatori ku merret deklarim shkresor per ankesen.
  - c- Nepermjet postes per ankesa te ndryshme.
  - d- Me e-mail ne adresen \_\_\_\_\_
- 2- Pajtimtaret kane te drejte te ankohen apo te kerkojne sqarime tek operatori qe ofron sherbime te komunikimeve elektronike per kushtet kontraktore dhe/ose permbushjen e ketyre kushteve nga operatori, perfshire faturen dhe cilesine e sherbimit te ofruar.
- 3- Afati i paraqitjes se ankesave me shkrim, nese pajtimtari nuk ka ngelur i kenaqur me sqarimet e dhena nga operatori nepermjet telefonit apo njoftimeve te tjera me mjetet elektronike, eshte:
  - a- Ankesat per “Difekte Teknike” dhe “Asistence teknike per sherbimin e aksesit ne internet” paraqiten ne cdo kohe (sherbimi 24 oresh)
  - b- Ankesat per faturim paraqiten brenda 15 diteve nga marrja e fatures
  - c- Ankesa per cilesine e sherbimit e ofruar, brenda 15 diteve nga ofrimi i sherbimit.
  - d- Ankesa per mos riparim te difekteve te paraqiten menjehere pasi mbaron afati sipas pikave perkatese te kontrates.
  - e- Ankesat e tjera, te cdo lloji qofshin paraqiten sa me pare.
- 4- Ankesat , ne varesi nga natyra e tyre, shqyrtohen nga strukturat perkatese e Operatorit, mbeshtetur ne te dhenat e marra nga Deget apo Sektoret e tjere dhe konforme rregullave behet analiza dhe zgjidhja e tyre, konform afateve te parashikuara ne Kontraten e Pajtimit.
- 5- Afati i nformimit me shkrim te Pajtimtarit mbi rezultatin e shqyrtimit te ankesave eshte brenda 15 diteve kalendarike nga marrja e tyre.
- 6- Pergjigja per ankesen i dergohet pajtimtarit nepermjet menyrave te komunikimit si me poshte vijon:
  - Poste;
  - SMS;
  - Telefonate;
  - adrese elektronike (email);
- 7- Nese pajtimtari nuk eshte i kenaqur me pergjigjen e dhene nga Operatori, pajtimtari mund te kerkoje nga AKEP-i te zgjidhe mosmarreveshjen me Operatori, ose te ndjeke kerkesen ne rruge gjyqesore. Kerkesa e pajtimtarit, per zgjidhje mosmarreveshje ne AKEP, paraqitet me shkrim dhe duhet te permbaje fakte dhe prova, ne te cilat eshte bazuar. Kerkesa duhet te paraqitet ne AKEP brenda 15 diteve pasi pajtimtari te kete marre pergjigjen me shkrim nga Operatori.
- 8- Operatori mban nje rregjister te vecante per ankesat e paraqitura dhe pergjigjet apo vendimet respektive sipas kushteve te kontrates.